



Nr 69 prot

Tiranë, 2 Korrik 2026

Drejtuar : Znj.Diana Leka
Drejtores e Sekretariatit Teknik të Këshillit të Investimeve

Lënda : *Komente të DHTI-Tiranë rreth dy dokumenteve strategjike: "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030 dhe "Për miratimin e dokumentit Politik për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2026–2030"*

E nderuar znj.Leka,

Në radhë të parë ju falenderojmë për organizimin e mbledhjes së K. të Investimeve dhe diskutimit rreth dy dokumentave strategjike, të strategjisë kombëtare të Industrisë për periudhën 2026-2030 dhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Gjithashtu falenderojmë edhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, veçanërisht ekspertët e angazhuar në përgatitjen e këtyre dokumentave strategjike.

Duke i parë me vëmendje këto dy dokumenta strategjike, konstatojmë se janë shumë voluminozë. Është një qasje që krijon vështirësi për të kuptuar se çfarë: mbështetje ligjore, financiare, nxitës fiskalë dhe masa në përmirësimin e klimës së biznesit dhe sigurisë ligjore për investimet do të ndërmerren gjatë viteve të zbatimit të objektivave, me indikatorë të matshëm dhe në dobi të sipërmarrjes shqiptare.

Strategji të trajtojnë një gamë të gjerë politikash dhe statistika, por mungon objektivi qendror i të dy dokumenteve, që është *Konkurrueshmëria*.

Në ekonominë e Bashkimit Evropian, politika industriale nuk synon thjesht rritjen e numrit të ndërmarrjeve apo investimeve, por rritjen e *produktivitetit, eksporteve, vlerës së shtuar dhe pozicionit në zinxhirët globalë të vlerës*.

-Referuar Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030, në objektivat dhe masat e parashikuara, mungojnë buxhetet dhe afatet për sektorët kryesorë të industrisë, që përbejnë bazën e ekonomisë shqiptare.

Qasja e kësaj strategjie konsiderohet një strategji horizontale dhe *nuk evidentohen sektorët e industrisë që do të mbështeten*. Strategjia duhet të japë zgjidhje se cilët sektorë të industrisë do të zhvillojë Shqipëria. Psh: industria agro-ushqimore, farmaceutika, automotivë, industria nxjerrëse, elektronika, mobilje, materiale ndërtimi, tekstilë, përpunim metalesh etj.

-Sektorët e industrisë përpunuese në Shqipëri prodhojnë me kosto të larta rreth 40% më shumë krahasuar me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

-Lind e nevojshme që të bëhet një skanim i performancës së sektorëve të industrisë, pasi sipërmarrja po bën investime me kosto të larta dhe kjo industri e ngritur deri tani nuk është konkurruese. Nëse nuk përcaktohen prioritetet sektoriale të kësaj industrie, fondet që mund të alokohen shpërndahen pa fokus.

-Mungojnë kostot financiare për realizimin e objektivave të kësaj strategjie. Aq më tepër që për sektorët kryesorë kërkojnë buxhete të dedikuara dhe objektiva me afate për zbatimin e tyre në

harkun kohor të 5 viteve se ku do të arrijme. *Gjithashtu nuk identifikohen qartë burimet financiare, me kontributin e buxhetit të shtetit; donatorët dhe fondet IPA.*

-Financimi i sektorëve duhet të lidhet edhe me performancën tyre. Fondet, veçanërisht grantet duhet të shërbejnë si stimul për rritjen e eksporteve; rritjen e produktivitetit; certifikimet; inovacionin; dhe numrin e vendeve të punës me kualifikim të lartë.

-Një zë i veçantë në kostot financiare duhet të jetë ekonomia qarkulluese, fonde dhe instrumenta nxites për teknologjinë e gjelbër, për zhvillimin e qëndrueshëm, zbatimin e standardeve ESG.

-Produktiviteti duhet të jetë treguesi kryesor. Shqipëria vazhdon të ketë një produktivitet pune dukshëm më të ulët se vendet e rajonit dhe mesatarja e BE-së. Sipas të dhënave të institucioneve ndërkombëtare (OECD, Eurostat dhe Banka Botërore), produktiviteti për punonjës në Shqipëri mbetet rreth 30–35% e mesatares së BE-së, ndërsa në vende si Serbia dhe Mali i Zi ky raport është më i lartë.

-Eksportet janë ndër objektivat dhe masat që kërkojnë një vëmendje konkrete ndaj industrisë, ku të gjejnë pasqyrim programet për nxitjen e eksportit, promovimi i markës "Made in Albania"; certifikimet sipas standardeve ndërkombëtare; mbështetje për pjesmarrje në panairë tregtare ndërkombëtare; inteligjencë tregjesh, ndërkombëtarizimi etj.

-Politika dhe masat për nxitjen e Investimeve të huaja, veçanërisht për zonat dhe parqet industriale, kërkojnë masa, investime konkrete në infrastrukturë, në furnizimin me energji, ujë gaz etj, dhe buxhetimin e tyre.

-Në planin e masave për zbatimin e kësaj strategjie të industrisë do të propozonim disa masa:

-Ngritja e Akademisë Kombëtare të Eksportit;

-Fondi i Certifikimit, mbështetje për: ISO; HACCP; GlobalGAP; certifikime të tjera europiane;

-Krijimi i një Platforme Digjitale për eksportuesit, një databazë kombëtare e kompanive eksportuese shqiptare;

-Fondi për Transformimin Teknologjik, për industritë që do të mbështeten, si një prove konkrete e bashkëpunimit ndërmjet sektorit të industrise me Universitetin/Akademine.etj

-Referuar Projektvendimit "Për miratimin e Dokumentit Politik për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2026–2030", strategjia nuk qëndron në krijimin e instrumenteve të reja, por në koordinimin e politikave ekzistuese nga MEI brenda një kuadri koherent që mbështet integrimin e NVM-ve shqiptare në zinxhirët evropianë të vlerës dhe konvergjencën me Tregun e Brendshëm të BE-së.

-Sektori i NVM-ve vazhdon të përballet me kufizime të rëndësishme strukturore; Produktiviteti mbetet i ulët krahasuar me mesataren e BE-së; adoptimi i teknologjive të avancuara dhe i praktikave moderne të menaxhimit mbetet i kufizuar; pjesëmarrja në eksporte dhe në zinxhirët ndërkombëtarë të vlerës është e vogël; ndërsa mospërputhja e aftësive, aksesit i kufizuar në financë dhe vështirësitë në përmbushjen e standardeve dhe kërkesave rregullatore ndërkombëtare bëjnë që SME-t të jenë të pamundura të kalojnë nga mbijetesa drejt rritjes dhe konkurrueshmërisë, të cilat konsiderohen sfida të zbatimit të kësaj strategjie.

Në matricën dhe planin e veprimit të kësaj strategjie, në këte hark kohor prej 5 vitesh të evidentohen ndërhyrje konkrete legjislative, administrative, mbështetje financiare, fonde për transferim teknologjie, fonde për certifikimin e produkteve, politika nxitëse fiskale etj.

Nga këndvështrimi i DHTI-Tiranë mendojmë se: Fuqizimi i SME-ve eksportuese është një prioritet kombëtar për rritjen ekonomike, punësimin cilësor dhe integrimin evropian.

-Për financimin e SME-ve: mungojnë shifra konkrete për fonde grant ose kredi me interesa të ulta që do jenë në dispozicion gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të kësaj strategjie;



- Konkretizimi i bashkëpunimit Akademi/Universitet -biznes, skema nxitëse financiare që të mbështesin këtë bashkëpunim me suportin e qeverisë.
- Për kushtet e Shqipërisë, mendojmë se *tre indikatorë performance/ KPI-të më të rëndësishëm deri në vitin 2030 duhet të jenë: (i) produktiviteti i SME-ve, (ii) numri i SME-ve eksportuese dhe (iii) investimet në inovacion dhe teknologji*, sepse këta tregues lidhen drejtpërdrejt me konkurrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë shqiptare.
- Monitorimi dhe vlerësimi i planit të veprimit duhet të bëhet çdo vit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kryetari

Nikolin JAKA

